

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS



Investitori: **Kompania „JONI” SHPK**
Lloji i projektit: **Fabrikë për prodhimin e Betonit**
Ngastra kadastrale: **P-72310051-00909-1; 00911-2**
Vendi i quajtur: **ARA ZABELIT-FUSHA**
Zona kadastrale: **Mleqan**
Komuna: **Malishevë**
Aplikuesi i projektit: **z. Femi Kryeziu**

Nëntor 2024, Kijevë

Kompania "Joni" shpk me pronar Femi Kryeziu nga fshati Bubavec, Malishevë

Bazuar në rregulloren e saj lëshon këtë:

A U T O R I Z I M

Autorizohet Personi fizik e Licencuar pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor për Hartimin e Raporteve të Vlersimit të Ndikimit në Mjedis, me perpilues të raportit Dr.sc. Edona Kabashi-Kastrati, Ekologe.

Për hartimin e Raportit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për Fabrikën prodhimin e betonit e cila gjendet në parcelat nr. P-72310051-00909-1; 00911-2, në zonen kadastrale Mleqan, Komuna Malishevës.

**Investitori: Kompania
„JONI” Shpk
z. Femi Kryeziu, Pronar**

_____ v.v

**Hartuesi i Raportit:
Dr.sc. Edona Kabashi Kastrati
edonak88@gmail.com**

Përmbajtja	
1. HYRJE	6
1.1 Qëllimi	7
2.0. BAZA LIGJORE E PËRPILIMIT TË RAPORTIT MBI V.N.M.	7
2.1. Rregullativa ligjore	8
2.2. Metodologjia e punës.....	9
3.0 PËRSHKRIMI I PROJKTIT DHE VEPRIMTARISË	10
3.1 Qëllimi i zhvillimit te projektit	10
3.2 Përshkrimi i lokacionit dhe mjedisit	11
3.3. Potencialet ekzistuese	11
3.4 Pozita gjeografike	12
3.5 Popullata dhe Vendbanimet	14
3.6. Lidhjet e Komunikacionit	15
3.7. Natyra dhe Biodiversiteti	15
3.8. Kushtet klimatike	16
3.10. Relievi	16
3.11. Toka	16
3.12. Flora	17
3.13. Fauna	17
3.14. Seperator i Vajrave	17
3.15. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore	18
3.16. Peizazhi	18
3.17. Dukshmëria.....	19
5.0. INDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS	29
5.1 Ndikimet e mundshme ne shendetin e njerezve	30
5.2 Ndikimet ne ajër	30
5.3 Ndikimet në ujë.....	31
5.4. Ndikimet në tokë	32
5.5 Ndikimet ne klime.....	32
5.6 Nivelet dhe ndikimet e zhurmave	33
5.7. Ndikimi në Peisazh	33
5.8. Ndikimi në florë dhe faunë	33

5.9. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë	34
5.10 Ndikimet ne ekonomi	34
5.11. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	34
6.0. MARRJA E MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE.....	35
6.1 Masat për emetimet ne ajer	35
6.2 Masat për Shkarkimet në ujë.....	36
6.3 Masat për mbrojtjen e tokës	37
6.4. Masat për mbrojtjen e florës dhe faunës.....	39
6.5. Masat e marura për mbrojtjen nga zhurma	40
6.6 Masat e marura për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale	40
7.0 PLANI I MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TE MJEDISIT	41
8.0. RAPORTIMI	42
9.0. MARJA E MASAVE REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETEVE PRODHUESE	42
10.0 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	43
10.1 Konkluzione.....	43
10.2 Rekomandime.....	44

1. HYRJE

Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk është i rëndësishëm vetëm për njerëzit por është thelbësor dhe i nevojshëm për të gjitha qeniet në tokë. Njerëzit duhet të kuptojnë se si përdorimi i burimeve mjedisore dhe përfitimet që vijnë nga ato të mos dëmtohen por të jetë e mundur të përfitohet sot dhe në të ardhmen. Ndotja e mjedisit nënkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjesë të materialeve të ndryshme në ujë, tokë, ajër e cila shkakton ose mund të shkaktojë probleme mjedisore të përkoheshme ose të përhershme në balancën ekologjike të tokës. Së bashku me zhvillimin e madh që është bërë në industri të ndryshme në mënyrë të ngjashme me të njëjtën shpejtesi është rritur edhe sasia e mbetjeve nga përdorimi i të mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane të patrajtuara, emetimet e gazeve të dëmshme në atmosferë, përdorimi i kimikateve të reja pa marrë parasysh dëmet që mund t'i sjellin mjedisit kanë sjellë problemet mjedisore me të cilat ne përballlemi në ditët e sotme. Ndaj është e nevojshme që shoqëria të ndërgjegjësohet për t'a mbajtur sa më pastër mjedisin ku jetojmë duke marrë masat e duhura për trajtimin e mbetjeve si dhe emetimin e gazeve të dëmshme në atmosfere që gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme. Në mënyrë që të shmangen këto probleme njerëzimi duhet të mësoj se si të menaxhohen burimet natyrore në mënyrë të qëndrueshme. Pra, zhvillimi i qëndrueshem i burimeve natyrore nuk është gjë tjetër veçse përdorimi i tyre në mënyrë ekonomike nga brezat e sotem për të lënë këto burime të përdoren edhe nga brezat që do të vijnë. Qëndrueshmëria përfshin menaxhimin e gjithë përbërësve dhe burimeve natyrore e njëzore me qëllim që të pasurohen me kalimin e kohës dhe të sigurohet një mirëqenie për të gjithë. Zhvillimi i qëndrueshem nuk i pranon politikat të cilat çojnë në uljen e bazës prodhuese dhe lënë gjeneratat e ardhshme me prespektiva me të ulta (të varfëra) dhe/ose rreziqe me të mëdha se të tonat. Teknologjite që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshem përfshijnë kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjisë ripërtitshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kërkime shkencore. Vitet e fundit industria e ndërtimit në vendin tonë ka patur një zhvillim të madh. Kompanitë e ndërtimit në vendin tonë janë ndër subjektet e biznesit me më tepër fitim dhe që zhvillojnë një aktivitet të madh ekonomik. Vet sektori i

ndërtimit në vendin tonë është një nga shtyllat e ekonomisë dhe numëron një numër të konsiderueshëm të punësuarish, në një kohë që kompanitë e ndërtimit sot janë ndër taksa-paguesit më të mëdhenjë të arkës së shtetit. Aktiviteti të cilin në do të trajtojmë është "Impiant i prodhimit të betonit".

1.1 Qëllimi

Procedura e marrjes së pëlqimit mjedisor nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nënkupton hartimin e raportit të vlerësimit të ndikimit në Mjedis, me qëllim që të identifikohen dhe analizohen ndikimet në mjedis të tërë veprimtarisë së bazës së betonit duke i parashtruar dhe ndërmarrë masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokacionin ku ushtrohet kjo veprimtari, andaj kompania "JONI" SHPK në zonën kadastrale Mleqan ka filluar procedurat përgaditore të kompletimit të dokumentacionit të nevojshëm për t'u pajisur me pëlqimin mjedisor.

Qëllimi i investimit të këtij aktiviteti, është prodhimi i betonit për nevoja të tregut të ndërtimit të lartë dhe të ulët. Projektet e tilla vendore, kanë rëndësi të veçantë, sepse e rrisin vlerën ekonomike të vendit, tregut dhe ngritin buxhetin e Kosovës. Pavarësisht nga kjo, për çdo ndërtim edhe më të vogël kërkohet një harmoni dhe balancim i shfrytëzimit të resurseve të natyrës ndaj mjedisit, me qëllim të shfrytëzimit të planifikuar dhe racional të tij. Gjatë aktiviteteve të tilla industriale, gjithnjë duhet pasur kujdes për ruajtjen e mjedisit jetësorë edhe për gjeneratat e ardhshme.

2.0. BAZA LIGJORE E PËRPILIMIT TË RAPORTIT MBI V.N.M.

Raporti i VNM-së përfshin identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti ambiental gjatë funksionimit kontinuel të bazës për prodhimin e betonit edhe atë:

- Identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- vlerësimin e ndikimit në mjedis
- propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin gjerë në kufijtë e lejuar.

2.1. Rregullativa ligjore

a) Dokumentacioni normativ në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis – VNM është aprovuar dhe funksionon ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 i cili përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM-së. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 ka për qëllim për të siguruar mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim që të parandalojnë dhe të zvogëlojnë apo mënjanë efektet negative në mjedis në kohën e duhur. Ligjet me të rëndësishme të aplikuara për hartimin e VNM-së për projektin e bazës së prodhimit të betonit janë si me poshtë:

- Ligji për VNM Nr. 08/L-181
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për minierat dhe mineralet Nr. 03/L-163
- Ligji Nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet.
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji Nr. 08/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja nr. 08/L-025
- Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturinat
- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012

Udhëzimit Administrative:

- Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor.

- Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajer nga burimet e palevizshme të ndotjes.
- Udhëzim administrative MMPH Nr. 04 /2018 për pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme.
- Udhëzimi administrativ nr. 13/2013 për katalogun Shtetëror të mbeturinave.

b) dokumentacioni teknik

Gjatë hartimit të raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, përpos eksperiencës profesionale në udhëheqjen e procesit teknologjik për prodhimin e betonit dhe konsultimeve që janë bërë me ekspertët që udhëheqin procesin teknologjik, janë shfrytëzuar:

- Projekti kryesor i ndërtimit të betonierës
- Projekti kryesor teknologjik i betonierës
- Projekti kryesor i maqineris të betonierës
- Certifikata e biznesit
- Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme
- Kopja e planit të ngastrës
- Situacioni i terrenit

Krahas parashikimeve themelore nga rregullativat ligjore të cekura më lartë për nevoja të hartimit të raportit të VNM-s janë shfrytëzuar edhe rregullativa tjera ligjore, duke përfshirë ligjet aplikative të cilat tani janë në fuqi. Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërhënuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar edhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse për mjedis siç është direktiva e VNM-së.

2.2. Metodologjia e punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për bazën e betonit bëhet në disa faza edhe atë:

a) Informatat themelore që nënkupton identifikimet siç janë:

- burimet themelore të ndikimeve në mjedis.

- popullata ekzistuese me karakteristikat demografike.
- karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacionin ku është ndërtuar baza e betonit.
- klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike.
- kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë.
- bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar.

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve:

- madhësia dhe lloji i ndotjes
- karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
- gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar
- vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse

c) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin ku është ndërtuar baza e betonit. Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet kuantifikimit dhe vlerësimin të gjendjes ekzistuese. Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që ka të bëjë me potencial të shprehur ekologjik. Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

3.0 PËRSHKRIMI I PROJKETIT DHE VEPRIMTARISË

3.1 Qëllimi i zhvillimit të projektit

Qëllimi i këtij aktiviteti është prodhimi i betonit për industrinë e ndërtimit dhe qëllime tjera e cila vitet e fundit ka një zhvillim të madh. Për të realizuar këtë aktivitet kompania ka ndërtuar një linjë me teknologji bashkëkohore të prodhimit. Të gjitha proceset e punës që nga sigurimi i lëndëve të para e deri në prodhimin e produktit përfundimtar që është betoni do të zbatohen konform akteve ligjore në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij. Kjo zonë ku do të funksionojë betoniera ndodhet ndërmjet fshatit Mleqan dhe Kijevë, ku parcelat kanë qasje në rrugën kryesore Prishtine - Pejë, lokacioni ku është vëndosur baza e betonit nuk është zonë e mbrojtur, apo park kombëtar, nuk ka monumente kulture, arkeologjike, vepra të ndërtuara nga njeriu, zogj


të egër dhe drurë të rrallë që mbrohen me ligj. Pra me këtë vlerësim mjedisor japim informacion për projektin që do të realizohet, vlerësimin e ndikimeve negative dhe pozitive në mjedis, si dhe masat që do të merren nga investitori për zbatimin e kriterëve për mbrojtjen e menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit.

3.2 Përshkrimi i lokacionit dhe mjedisit

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e raportit të VNM-së. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren. Për t'u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për të u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

3.3. Potencialet ekzistuese

Njëri nga elementet kyç të hulumtimi i gjendjes ekzistuese të mjedisit është hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore në zonën më të gjerë të lokacionit ku është ndërtuar baza për prodhimin e betonit, me qëllim që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësit e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre. Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyror si që janë toka, uji, ajri, reliefi, flora dhe fauna. Çdonjëri nga potencialet ekologjike në këtë mënyrë posedon funksione të caktuara, që në esencë kanë rëndësi të dorës së parë analizën e problematikës së tërësishme të mbrojtjes së mjedisit. Është e qartë që faktorët natyror formojnë disa potenciale natyrore karakteristikat funksionale të të cilave duhen marrë parasysh gjatë valorizimit të ndikimit të bazës së betonit për prodhimin e betonit të ndërtuar në hapësirën konkrete.



3.4 POZITA GJEOGRAFIKE

Lokacioni për të cilin hartohet raporti ndodhet në zonën kadastrale Mleqan komuna e Malishevës, përkatësisht në rrugën magjistrale Prishtinë-Pejë. Vendi ku është vëndosur baza e betonit ndodhet në pjesën e ngastërave kadastrale nr. **00909-1; 00911-2**, dhe me nr. të njësisë kadastrale **P-72310051-00909-1; 00911-2** me sipërfaqe totale **4984 m²**, lloji i shfrytëzimit të parcellës është **Bujqësore**, me shfrytëzim aktual **Ara**, ndërsa kualiteti i klasës janë **Arë e klasës 4**, gjithnjë sipas fletës poseduese me nr. të lëndës **45505/24**, lëshur nga zyra e kadastrit në komunën e Malishevës me datë **31.10.2024**. Parcelat i përkasin zonës kadastrale **Mleqan** komuna Malishevë në vendin e ashtuquajtur **ARA ZABELIT-FUSHA**, zonë rurale pjesa e ngastrës kadastrale që investitori i betonierës kërkon pëlqim mjedisore është pronë e private në emrin e pronarit të biznesit “JONI” shpk z. Femi Kryeziu.

Lokacioni ku ndodhet ky objekt është e kyqur drejtëpërdrejtë në rrugën magjistrale Prishtinë-Pejë, qasja në rrugë është e lehtë dhe të përshtatshme për hyrje dalje, për rreth dhe përballë këtij projekti ka objekte tjera afariste me veprimtari të ndryshme, poashtu ka edhe shtëpi të banimit në një distanë më të largët. Në këtë pjesë të fashtit përkatësisht në pjesën rreth lokacionit të lartë cekur ndodhet një depo, disa autoservise, një pomp e benzines dhe restaurante, pastaj fillojnë edhe shtëpit e banimit, por të cilat nuk afektohen

nga ky aktivitet. Meqënëse shtëpit e banimit ndodhen në një distancë të konsiderushme, ky projekt nuk i atakon ato në këtë zonë, sepse duke marrë parasysh natyrën e punës dhe kapacitetin e prodhimit, ky aktivitet që paraqet penges për banoret e kësaj ane. Vendi ku po realizohet ky projekt ka një territor të përshtatshëm për këtë veprimtari, gjithashtu është rregulluar dhe projektuar nga ana e investitorit dhe projektuesit për një funksionalizim sa më të përshtatshëm. Terreni ku është e vendosur baza e betonit është zonë e rrafshhtë, por gjithësesi në këtë parcellë investitori ka mbushur një pjesë dhe e ka arritur nivelin e rrugës. Ky lokacion i territorit të komunës së Malishevës është një zonë rurale dhe i plotëson të gjitha kushtet për ndërtimin dhe zhvillimin e këtyre veprimtarive. Vendi ku ndodhet betoniera, ka një territor të përshtatshëm për këtë veprimtari, dhe është rregulluar dhe projektuar nga ana e pronarit për një funksionalizim sa më të përshtatshëm. Në lokalitetin përreth impiantit, nuk zhvillohet ndonjë veprimtari e karakterit të ngjajshëm, kryesisht zona përreth është e mbjell me kultura sezonale ku dominojnë bimë të familjes *Poaceae*, *Fabacea* etj. Pamja e lokacionit për ndërtimin e impiantit, për të pasur më të qartë është e përcjell me foton në vazhdim.





Foto 1. Pamje satelitore e lokacionit

3.5 Popullata dhe Vendbanimet

Vendndodhja e bazës së betonit është në fshatin Mleqan, në anën e majtë të rrugës Kijevë – Orllat (Pejë-Prishtinë). Në lokalitetin përreth nuk hasëm ndonjë veprimtari punuese industriale të llojit të ngjajshëm, ndërsa ka një numër të madhë të aktiviteteve të ndryshme biznesore. Ky projekt, do të jetë lehtësim për pronarin për funksionalizimin e veprimtarisë që tashme e ushtron atë të prodhimit të betonit. Sipërfaqja e përgjithshme e lokalitetit është **4984 m²**, kryesisht është zonë e rrafshët, ky lokacioni është i ndarë në dy parcela me numra të ndryshëm, në një zonë të rrafshët dhe të sigurt për zhvillimin e këtij aktiviteti. E gjitha zona përreth është e karakterit të arave me lloje kryesisht të bimëve barishtore, me kultura bujqësore të mbjella nga ana e bujqëve të asaj ane, pastaj shkurre e gjysëmshkurre, karakteristike për këto habitate dhe atë zonë. Vendi se ku ndodhet baza e betonit është paraqitur më mirë dhe më qartë në foton më lartë, marrë nga pamja satelitore. Shtëpitë e zonës së banuar të fshatit nuk janë në afërsi, ato gjenden në largësi nga impianti mbi 120 metra. Infrastruktura është e përshtatshme, por prapë së prapë duhet marrë iniciativë nga vetë pronari për rregullimin e infrastrukturës, për interesat e punës së këtij impianti.

Kjo pozitë dhe ndërtimi, kanë rol të rëndësishëm, sepse çfarëdo ndikimi i mundshëm, nga ana e pronarit është marrë që të këtë ndikim minimal në mjedisin përreth. Rruga është e rregulluar dhe e kyqur drejtëpërdrejtë në rrugën kryesore që lidh Kijevën me Orllatin, për një furnizim të rregullt dhe të lehtë me lëndët e para dhe për transportin e betonit. Njërin nga veçoritë qenësore të hapësirës së analizuar, në kuptim të përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis, e paraqet popullata dhe demografia e saj. Këto fakte kuptimin e plotë të tyre e kanë në hulumtimin e hollësishëm të ndikimeve të mundshme negative në banorët që jetojnë në hapësirën e analizuar. Komuna e Malisheves në bazë të sasisë së ujit është një ndër vendet më pak të pasura. Kjo pozitë krijon parakushtet të vogla për zhvillimin e kulturave bujqësore, blegtorisë, industrisë ushqimore dhe të turizmit.

Kushtet hidrologjike dhe kushtet natyrore të komunës së Malisheves ndikojnë në zhvillimin e bujqësisë dhe për zhvillimin e aktiviteteve turistike dhe rekreative.

E gjithë kjo ka ndikim në strukturën ekonomike prandaj bujqësia dhe turizmi merret si pjesë madhore e aktiviteteve ekonomike në komunën e Malisheves dhe me gjerë.

Përmes anës së Malishevës kalon Autostrada "Ibrahim Rugova" e cila bashkon pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik me detin Adriatik. Ndërsa Baza për prodhimin e betonit në pikëpamje mjedisore, nuk do të këtë ndonjë ndikim relevant në popullatë, përpos që do të kenë vetëm dobi sepse një numër i popullates mund edhe të përfitojnë nga ky aktivitet, duke u angazhuar me punë të përhershme dhe duke marrë shërbime.

3.6. Lidhjet e Komunikacionit

Lokacioni ka lidhje mjaft të mira komunikacioni afër bazës së betonit kalon rruga kryesore Kijevë - Orllat dhe e cila pastaj lidhet me rrugën superstraden Prishtinë - Pejë. Furnizimi me energji elektrike e bazës për prodhimin betonit bëhet përmes rrjetit elektrik dhe trafos private, që e ka ndërtuar pronari i kompanisë, infrastruktura e ujësjellësit dhe rrjeti i kanalizimit është e rregulluar.

3.7. Natyra dhe Biodiversiteti

Hapësira përreth vendit ku ndodhet baza e betonit është habitat natyror, e karakterit bujqësor, ara të klasit të 4. Në këtë zonë, dominon kryesisht vegjacion barishtor dhe

karakteristike janë të mbjellat e arave kryesisht me bimë të familjes *Poaceae*, *Fabaceae* etj. Habitati kryesisht karakterizohet me një laramani bimore, që krijon një pamje të bukur në kohën e vegetacionit të kësaj zone. Gjatë punës së rregullt të betonierës mundësit e ndotjes vijnë nga:

- Automjetet e caktuara motorike të parkut të betonierës,
- Emisionet e pluhurit nga siloset,
- Emisionet nga gjeneratori,
- Ujërat e pa trajtuara pas procesit të larjes së rërës dhe zhavorit,
- Larja e mikserëve,
- Derdhja aksidentale e vajrave hidraulik dhe motorik, etj.

3.8. Kushtet klimatike

Atmosfera është një sistem dinamik i cili vazhdimisht ndodhet në interaksion me komponentët e ndryshme të ndotjes. Si rezultat i interaksioneve mes komponenteve të ndryshëm mjedisor paraqitet ndotja sekondare, të cilat shprehen me ndryshimin e karakteristikave fizike të temperaturës, regjimit të dritës, sasisë së të reshurave dhe parametrave tjerë në plan lokal, ose ndryshime të mundshme edhe në planin global, por edhe potencimi me i madh i dëmit të të njëjtit përqëndrim të ndotjes, varësisht prej rrethanave të motit (psh: dukuria e inversionit të temperaturës). Vendi ku zhvillohet aktiviteti, është rajon i përshkruar me klimë të mesme kontinentale, me dimër relativisht të ftohtë, si dhe verë të nxehtë.

Temperaturat maksimale arrihen gjatë verës, mesatarisht $+24.6^{\circ}\text{C}$, ndërkaq ato minimale shfaqen në janar, në vlera mesatare -10°C . Të reshurat atmosferike sillen prej 511-1108 mm në vit.

3.10. Relievi

Rajoni i shtrirjes së lokacionit të bazës së betonit, në pjesën e majtë të rrugës Prishtinë – Pejë në zonën kadastrale Mleqan komuna e Malishevës, karakterizohet me një reliev të rrafshhtë, me lartësi mbidetare të ndryshueshme nga 550-600 m.

3.11. Toka

Në aspektin pedologjik, toka ku po e realizon punën impianti për prodhimin e betonit dhe objektet tjera përcjellëse, bënë pjesë në tokat mesatarisht të zhvilluara, me një shtresë të

humusit mesatarë. Kjo sipërfaqe e tokës mund të shfrytëzohet për aktivitetin që mendohet të zhvillohet, pavarësisht që toka ka pësuar degradim gjatë largimit të bimësisë që kanë qenë aty dhe që mund të jetë shfrytëzuar si tokë bujqësore, si dhe për ndikimin negativ që mund të shkaktoj ky aktivitet në bashkësitë bimore.

3.12. Flora

Në bazë të shqyrtimeve vizuale në rrethin të zonës ku realizohet projekti kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ulta barishtore, kurse në lokacionin më të gjerë bimësi drusore si, kaça, murrizi, mana, manaferra, kurse ngastra ku është ndërtuar baza për prodhimin e betonit më herët kanë qenë i populluar me bashkësi bimore të bimëve barishtore kurse tani nuk ekziston kjo bimësi në këtë sipërfaqe, sepse në të është e ndërtuar baza për prodhimin e betonit. Në bazë të shqyrtimeve vizuale të zonës ku zhvillohet veprimtaria, kemi hasur kryesisht në shkurre e gjysëmshkurre si dhe forma barishtore e kultura bujqësore. Flora e kësaj zone, shtrihet në një lartësi mbidetare të konsideruar. Në këtë zonë, janë prezent edhe bimët të tjera, që u përshtaten kushteve të rajonit.

3.13. Fauna

Flora ekzistuese dhe kushtet klimatike të kësaj ane, duke marrë për bazë edhe të dhënat nga vendasit, në këtë zonë jetojnë:

- Gjitarët: Lepuri i egër, kafshë endacake
- Zvarranikët: Gjarpri, Hardhuca, Breshka e tokës, etj.
- Brejtësit janë evidentuar: Minjtë, etj.
- Nga insektet krahë fortë, krahë lusporë, janë evidentuar lloje të ndryshme të fluturave, Bletës mjaltë dhënëse, llojeve të ndryshme të thneglës, Mizat, mushkonjat, etj.
- Ndërsa prej shpezëve janë karakteristike: Bilbilat, zogj etj.

3.14. Seperator i ujërave të shkarkuara

Ujërat e shkarkuara nga zhvillimi i aktivitetit janë paraparë të kenë rënie dhe të grumbullohen në seperatorin për trajtimin e ujit. Pastaj nga seperatorin, ato do të kalojnë përmes gropës ndarëse në gropën grumbulluese septike. Seperatorin duhet të jetë gjithmonë në monitorim, sepse paraqet elementin pothuajse më të rëndësishëm të

impiantit. Gropa septike, duhet të jetë afër impiantit dhe të zbrazet periodikisht në mënyrë të organizuar. Problem paraqesin edhe ujërat atmosferike ose ato të pasuruara me mbeturina të naftës dhe derivateve të tjera, nëse vijnë deri te derdhja e pa kontrolluar e tyre, apo ekseseve të tjera gjatë punës. Efekti negativ i derivateve të naftës në procesin e auto-purifikimit të ujërave nëntokësore është mjaftë i lartë, sepse në të njëjtën kohë vije edhe deri te bymimi i dheut, gjë që e ngadalëson procesin e pastrimit. Investitori, është i detyruar që në mënyrë rigorozë të bëjë mbikëqyrjen e ujërave të shkarkuara në seperator, si dhe zbrazja e tyre nga tejmbushja, nga ndonjë kompani e licencuar për këtë veprimtari ose të bëjë riciklimin e atij uji.

3.15. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore

Karakteristikat hidrogjeologjike të lokacionit janë të thjeshta. Morfologjia, ndërtimi gjeologjik, tektonika janë faktorët dominantë të cilët definojnë lëvizjen e ujërave sipërfaqësor dhe ato nën tokësor.

Në afërsi të lokacionit ku është ndërtuar baza për prodhimin e betonit, burime natyrore të ujit dhe rrjedha te lumit nuk ekzistojnë, ujërat sipërfaqësore të cilat krijohen gjatë të reshurave atmosferike, drenohen në kanalet natyrale (prrockat) dhe pastaj drenohen në lumin i cili gjendet në distancë jo të largët nga baza e betonit.

Në aspektin hidrologjik ujërat sipërfaqësorë të komunës së Malisheves karakterizohen me ujera jo të bollshme sipërfaqësore të cilat nepermjet lumit Mirusha drenohen në pellgun e lumit Drini i Bardhë.

3.16. Peizazhi

Pamja e këtij regjioni është karakteristike, shumë e bukur e kombinuar, e përbërë nga rrafshira të pasura me bimë të ulëta, dhe një pamje imponante që i jep pozita gjeografike e lokaconit ku është ndërtuar betoniera. Lokaliteti, ku ndodhet impianti me objektet përcjellëse dhe me infrastrukturën e nevojshme që do të ketë, është jo shumë largë rrugës kryesore për ndërtimin e së cilës është dashur të hapet një pjesë e konsiderueshme e pyllit në fjalë. Gjatë fazës së ndërtimit sikur që u cek më lartë është dashur të mbushet një pjesë e tokës për të krijuar sipërfaqen e nevojshme për objektin dhe infrastrukturën përcjellëse, por parashihet që peizazhi nuk do të pësoi ndryshime të mëtutjeshme dhe degradim, dhe

si i tillë nuk ka nevojë të parashihet masa shtesë, të cilat do të duhej të merren. Operatori është i obliguar, që të mendoj dhe të kontribuoj në kultivimin e bimësisë në oborrin betonierës, në mënyrë që të minimizoj humbjet në aspektin floristik që janë bërë, poashtu që të siguroj një mjedis të këndshëm edhe për stafin e kompanisë.

3.17. Dukshmëria

Shikuar nga relievi, ku është ndërtuar objekti dhe objektet e tij përcjellëse, dukshmëria është e lartë dhe deri diku atraktive, mund të mbërrijë gjerë në disa kilometra.

3.18. Ndikimi në ujëra

Ndotja e ujit nënkupton të gjitha ndryshimet kualitative apo kuantitative të përbërjes dhe cilësisë natyrore kimike, fizike dhe biologjike, të cilat mund të shfaqin pasoja të padëshirueshme për shëndetin e njeriut, ekonominë dhe ekosistemin në përgjithësi. Natyra dhe llojet që atakojnë ujërat janë të ndryshme, nga burime të ndryshme. Duke marrë parasysh prejardhjen e tyre, në përgjithësi, ndotjet mund të karakterizohen si: urbane, industriale, bujqësore, etj. Kuptohet se sipas kualitetit dhe karakteristikave të tyre, ujërat efluate urbane dhe ato industriale dallohen në mes vete dukshëm. Është e qartë se tipet e ndryshme të ndotësve zakonisht kanë efekte të ndryshme biologjike. Këto ujëra, pas përdorimit gjatë punës së impiantit, duhet të nënshtrohen procesit të trajtimit dhe të futën në riciklim, por kompania akoma nuk ka siguruar mekanizmin e trajtimit të ujrave. Andaj rekomandohet që kompania të sigurojë/ndërtojë sistemin e trajtimit të ujërave sepse ndikimi mund të jetë negativ për mjedisin.

4.0 PROCESI TEKNOLOGJIK I PRODHIMIT TË BETONIT

4.1. Objektet dhe pajimet prodhuese

Kompania "JONI" SHPK nga komuna e Malishevës e cila si aktivitet kryesor ka prodhimin e llojeve të betoneve në zonën kadastrale Mleqan komuna e Malishevës ka të vendosur një betoniere dhe pajimet që do të shënohen në vijim:

Baza për prodhimin e betonit përbëhet prej këtyre objekteve dhe pajisjeve:

- Objekti i administratës
- Tipi i Betonierës: PI-MACINA

- Viti i prodhimit: 2010
- Vendi i origjinës: Turqi
- Betoniera me kapacitet te prodhimit 80 m³/orë,
- mikseri kapaciteti 3 copë: 3x9 m³.
- pompa 1 copë me gjatësi 60 m.
- Siloset për Çimento 2 copë me kapacitet 2 x 80 m³.
- Bunkerët për fraksione, kater siloset me kapacitet nga 4 x 60m³ =240 m³, me kater lloje fraksionesh të agregatit: +0-4mm; +4-8mm; +8+16mm; +16-22mm; dhe +16-31,5mm.
- Makinë ngarkuese e rërës 1 copë
- Kapaciteti i pompës: 100 m³/h
- Kompresori për furnizim me ajër të komprimuar (P =7.5 kË, V= 500 litra),
- Peshojat automatike për matjen e agregatit dhe çimentos.
- Shiriti transportues horizontal mbledhës – dozatori,
- Shiriti transportues i pjerrët për furnizim me agregat me gjatësi 13 m
- Rezervari për aditive me kapacitet prej 1000 litra, pompa e aditivit
- Rezervari për ujë me kapacitet prej 2 x 30 000 litra,
- Pompa me sistemin e furnizimit me ujë,
- Deponia -platoja për fraksionet e agregatit 4 X 60 m³
- Shtyllat dhe platoja metalike ku është i vendosur mikseri (përziërsi).
- Shtyllat dhe platoja ku janë të vendosur silosët e çimentos
- Gjeneratori për furnizim me energji elektrike, me kapacitet 110 kW/h
- Trafo te rrymes (personale) 150 kW
- Pus personal
- Kabina komanduese e bazës së betonit,
- Hapësira dhe pompa për pastrimin e autocisternave,
- Euro filtrat në siloset e çimentos, Betoniera është adekuate për prodhimin e betonit dhe i përgjigjet ISO standardeve.
- Trajtimi i ujrve - ende nuk posedon system per trajtimin e ujrave

Ne fotot në vijim shihet baza për prodhimin e betonit dhe pajisjet e bazës nga disa pozicione të ndryshme.



Foto 3. Betoniera me elementet përcjellese

4.2. Koncepti prodhues i bazës së betonit

Kompania “JONI” SHPK nga komuna e Malishevës ka të ndërtuar bazën për prodhimin e betonit me teknologji dhe pajime me të cilat mund të prodhojë të gjitha llojet e betonit të cilësisë së lartë. Materialet e nevojshme për prodhimin e betonit janë: çimentoja, fraksionet e gurit/rërës, uji dhe aditivët.

Fraksionet e gurit/rërës janë: +0-4mm, +4-8mm, +8-16mm, +16-22 mm, dhe +22-31.5 mm, varësisht prej llojit të betonit i cili planifikohet të prodhohet edhe fraksionet kombinohen.

Procesi i prodhimit të betonit është proces i mbyllur, i tërë procesi kontrollohet dhe menaxhohet në mënyrë bashkëkohore.

4.3. Prodhimet e betonit

Betoni paraqet konglomerat që përfitohet me përzierjen e çimentos, fraksioneve të rërës/gurit dhe ujit.

Me programin e prodhimit parashihet prodhimi i këtyre llojeve të betoneve:

- Betonet Plastike 0-16 (MB15, MB20, MB25, MB30, MB35, MB40)
- Betonet Plastike 0-31.5 (MB10, MB15, MB20, MB25, MB30, MB35, MB40)
- Beton i Ajruar 0-16 (MB20, MB25, MB30, MB35, MB40)
- Beton i Ajruar 0-31.5 (MB20, MB25, MB30, MB35, MB40)
- Beton i Qëndrueshëm ndaj ujit 0-16 (MB20, MB25, MB30, MB35,)
- Beton i Qëndrueshëm ndaj ujit 0-31.5 (MB20, MB25, MB30, MB35). Përpos këtyre llojeve të betoneve mund të prodhohen edhe lloje të veçanta të betoneve: për ndërtim të rrugëve, urave, tunele, për konstruksione nën ujë etj.

4.4. Komponentët në procesin e prodhimit të betonit

Çimentoja- paraqet komponentin lidhës të betonit. Sipas teknologjisë për prodhimin e betonit në betonier përdorët çimentoja Portland. Në raste të veçanta varësisht prej llojit të prodhimit të betoneve, përdoren çimentot speciale. Cilësia e çimentos përcaktohet në bazë të aftësisë lidhëse të shprehur nëpërmjet fortësisë. Sasia për prodhimin e betonit, përkatësisht harxhimi specifik i çimentos, është 200-400 kg për 1m³.

Agregati - guri /ose rëra kompania "JONI" SHPK, me këtë material (fraksionet e gurit gëlqeror/ose rërën) për arsye të cilësisë së lart të dëshmuar furnizohet nga gurthyesit dhe seperacionet në rajon.

Agregati duhet të përmbush kushtet e parapara në pikëpamje të cilësisë dhe granulimit. Rëra cilësore duhet të jetë e pastër dhe me përbërje të lartë të kuarcit. Agregati duhet të

jetë pa asnjë shtesë të cilat reagojnë me ujin dhe shkaktojnë shkapërderdhje, kloridet, sulfatet dhe komponimet tjera kimike që dëmtojnë vetit fizike dhe mekanike të betonit nuk gëzojnë të jenë të pranishme.

Materiet organike dhe humusi pengojnë ngurtësimin e çimentos në beton. Preferohet që raporti i agregatit në beton të jetë 1:2 - 1:7, varësisht prej llojit të betonit që kërkohet të prodhohet.

Uji- është komponent i rëndësishëm për lidhje gjatë prodhimit të betonit. Çështjen e ujit pronari e ka zgjidhur më anë të pusit, të cilin e ka shpuar me anë të pompave e mbushë rezervuarin i cili nevojitet për mbajtjen e ujit rezervë për nevoja të betonierës, pusi dhe rezervuari gjinden në afërsi të betonierës.

Në procesin e prodhimit të betonit duhet të përdoret vetëm uji i pastër, ujë që nuk përmban materie organike që formohen nga bimët e kalbura.

Harxhimi specifik i ujit në procesin teknologjik për prodhimin e betonit varet nga lloji i betonit që dëshirojmë të prodhojmë. Në vijim do të jpet përqindja e ujit në beton në varësi nga lloji i betonit:

- për beton të lëngshëm 6- 8%
- për beton plastik 7- 9%
- për beton të fortë plastik 8-10%

Siç kemi cekur në pasuset e më sipërme në këtë betonierë mund të prodhojmë beton të kualiteteve të ndryshme duke u bazuar në destinimin e tij dhe atë sipas nevojës dhe kërkesave të hargjuesve të betonit.

Në tabelën e më poshtme po e japim një shembull që paraqet sasinë e agregatit sipas fraksioneve dhe atë pa fraksionin +16-31.5 mm, sasinë e çimentos dhe sasinë e ujit që nevojitet për prodhimin e 1m³ beton llojit MB-30, sipas recepturës së caktuar:

Agregati

fraksionet	+0-4mm	+4-8mm	+8-16mm
përqindja	45%	20%	35%

4.5. Përshkrimi i procesit Teknologjik

Prodhimi i betonit në betonier fillon me përgatitjen e lëndëve të para: agregatit (fraksioneve të gurit apo fraksioneve të rërës), çimentos dhe ujit.

Procesi teknologjik për prodhimin e betonit, fillon me mbushjen e siloseve me guri gëlqeror me granulacione të ndryshme në varësi të markës së betonit që dëshirohet të prodhohet, siloset mbushen me anë të lopatës ngarkuese me fraksione të gurit ose rërës nga depoja e fraksioneve të agregatit, siloset janë të ndara njëra prej tjetrës me mure të pllakave të qelikut.

Proces tjetër paraqitet mbushja e siloseve me çimento të tipit të caktuar, mbushja bëhet me anë të auto-cisternave me proces pneumatik.

Në procesin teknologjik bëjnë pjesë tërë sistemi i pajimeve të furnizimit me ujë, pompave hidraulike, pneumatikës, pajimeve elektrike dhe automatike në veçanti.

a. Agregati nga të kater siloset ku në dalje të cilëve ndodhën dozuesit elektro- pneumatik te cilët me dhënien e komandës nga tabela komanduese hapen dhe mbyllen në mënyrë automatike pasi ta lëshojnë sasinë e caktuar të agregatit në shiritin transportues horizontal që ndodhet në siloset e agregatit i cili i transporton granulacionet (fraksionet) e agregatit gjer në shiritin transportues të pjerrtë i cili nevojitet për bartjen e fraksioneve të agregatit gjer në ku barten fraksionet gjer në mikser (përzierës) për prodhimin e betonit. Në dozuesit e fraksioneve më të imta janë të vendosur vibruesit me qëllim të rrjedhjes së fraksioneve sa më lehtë në shiritin transportues horizontal, kur të dozohet sasia e dëshiruar e agregatit, në transportier e pastaj nga transportieri shiritor në shiritin transportues të pjerrtë i cili nevojitet për bartjen e fraksioneve të agregatit gjer në mikser (përzierëse).

b. Dozimi i çimentos në përzierës bëhet nëpërmes transportuesit kërmillor nga siloset. Çimentoja me ramje të lirë bien në transportuesin të vendosur nën silos, pasandaj nëpërmjet transportuesit kërmillor dozohet në enën e peshojës për çimento. Zbrazja e enës së peshorës kryhet në mënyrë të programuar dhe atë në kohën e dozimit të agregatit

në mikser (përzierëse). Ashtu që zbraza e pajisjes për dozim të çimentos në mikser (përziërs) fillon automatikisht në momentin e fillimit të dozimit të agregatit në mikser (përzierës), apo disa sekonda më vonë. Gjatë kohës së zbrazjes së enës së peshojës me çimento duhet të lëshohet vibruesi, kur procesi kryhet në mënyrë emanuele, kur procesi kryhet në mënyrë automatike vibruesi lëshohet në mënyrë automatike.

c. Dozimi i ujit në përzierës si lëndë e parë bazë për përfitimin e betonit bëhet me dozimin e programuar nga pompa për furnizim me ujë kryhet gjithashtu në mënyrë automatike me fillimin e dozimit të çimentos. Pas dozimit të sasisë së caktuar të ujit, ventili dozues automatikisht mbyllet. Nëse janë përmbushë kushtet e procesit për punë automatike (sasia e nevojshme e agregatit në fortin, shtypja e ujit duhet të jetë min. 3at. dhe sasia e nevojshme e çimentos), sasia e prodhuar e betonit për një cikël është 1.5m³, zgjatja e një cikli është përafërsisht 60 – 90 sek. në varshmëri të llojit të betonit. Gjatë kryerjes së procesit në mënyrë emanuele koha e zgjatjes së ciklit varët nga aftësia e punëtorit që operon me pajimet për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit.

Para se të lëshohen pajimet për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit, duhet të kryhen këto veprime:

- Duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e agregatit në silose.
- Duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e çimentos dhe duhet hapur ventilin e silosit nga i cili dëshirojmë të marrim çimento.
- Duhet të sigurohet sasia e nevojshme e ujit.
- Duhet caktuar recepturën për kualitetin e betonit të cilin dëshirojmë të e prodhojmë.
- Të caktohet zgjatja e kohës së ciklit të prodhimit të betonit duke u bazuar në recepturën e caktuar. Pajimet mund të funksionojnë në mënyrë automatike me dozim të programuar dhe në mënyrë emanuele. Menaxhimi i procesit teknologjik i prodhimit të betonit, kryhet nga pulti komandues i automatizuar i vendosur në dhomën (hapësirën) të caktuar për te.

Modulet hyrëse drejtpërdrejt pranojnë sinjalet nga dozatorët dhe peshojat, nëpërmjet sondave për të gjithë komponentët e procesit të prodhimit. Modulet digjitale dalëse shërbejnë për menaxhimin e ventileve elektromagnetikë, motorëve si dhe llampave sinjalizuese. Menaxhimi i tërë procesit të prodhimit bëhet edhe përmes disa monitorëve të vendosur ne panelin e komandimit, përmes këtij paneli operatorit i mundësohet të bëjë mbikëqyrjen e ter procesit dhe recepturat për prodhimin e betonit, me këte mundësohet matja lehtë e komponentëve të agregatit, çimentos dhe komponentëve tjera shtesë. Për të arritur cilësinë e duhur të betonit bëhet sitja e çimentos me sita standarde dhe përcaktohet kohëlidhja e sajë. (Kohëlidhja e çimentos paraqet kohën nga momenti i përzierjes së çimentos me ujë gjer në momentin e fillimit të hidratimit të sajë dhe arritjes së fortësisë përkatëse). Përpos komponentëve të lartcekura për të arritur veçori specifike të betonit, duhet shtuar Aditivët. Në sezonin e dimrit dhe për konstruksione të veçanta shtohen aditivë të cilët e shpejtojnë kohën e ngurtësimit. Aditivi kryesisht shtohet me ujë, ose drejtë për drejt në mikser. Dozimi i aditivit kryesisht shtohet 2-4% të masës së çimentos. Për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit, me energji elektrike furnizohet nga rrjeti elektrik nëpërmjet trafos të ndërtuar nga kompania, gjithashtu ne mungesë të energjisë elektrike kompania posedon gjeneratorin për realizimin e procesit teknologjik.

Përpos pajisjeve të lartë cekura për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit dhe për bartjen e tij gjerë te hargjuesi (konsumatori), kompania disponon edhe këtë mekanizëm: auto mikserë, pompë të betonit, kamionë dhe lopata ngarkuese.

Bazuar në kërkesat dhe përvojën e punës në këtë betonier, punët organizohen vetëm ne ndërrimin e parë. Fuqia punëtore e angazhuar është e konsiderueshme dhe ka ndikim pozitiv në punësimin e popullatës.




Foto 1. Skema e procesit teknologjik për prodhimin e betonit



Foto 4. Lokacioi i Betonieres "JONI" SHPK

5.0. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS

Metoda e zbatuar për parashikimin e ndikimeve ne mjedis -Për vleresimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqen hapat e me poshtme:

- Njohja me projektin dhe teknologjinë e tij.
- Njohja me natyren e operacioneve të nevojshme në mjedis.
- Njohja me vleren natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes ku do te zhvillohet aktiviteti
- Njohja me infrastrukturen egzistuese dhe nevojën për infrastrukturë të rë për projektin.
- Njohja me lendet e para qe do te përdoren për zhvillimin e aktivitetit. Duke njohur teknologjine e prodhimit te betonit u indentifikuan ndikimet e mundshme negative në çdo receptore - përberes te mjedisit ne linjen e prodhimit.

5.1 Ndikimet e mundshme ne shendetin e njerezve

Zhvillimi i aktivitetit nuk ka ndikime në shendetin e popullsisë së zonës. Ky aktivitet nuk përdor lëndë të rrezikshme për shëndetin e punonjesve si dhe të popullsisë përreth zones dhe si rrjedhim nuk ndikon negativisht tek ata. Në projekt nuk janë parashikuar ndryshime në popullsinë e zones, të zhvendosjes së saj, për shkak të këtij projekti. Gjatë fazes së funksionimit të linjes nuk ka ndikime negative në shendetin fizik dhe mendor të popullsisë, por ka efekte pozitive në punësimin direkt të popullsisë së zones duke rritur kështu edhe nivelin e jetesës së tyre.

5.2 Ndikimet në ajër

Referuar natyrës së procesit nuk ka sasi gazesh të emetuara në atmosferë por vetëm përhapje të pluhurit, e cila është e pranishme në shesh gjatë kohës së thatë nga levizja e mjeteve në kohën e ngarkimit të materialit në bunkeret dhe depozitimet e ndonjë rast tek peshimi dhe furnizimi me çimento. Për shmangien e pluhurit bëhet spërkatje me ujë herë pas here në hapësirën e punës sidomos në kohën e thatë dhe me erë si dhe hermetikizim sa më i mirë në linjën e furnizimit nga siloset në përzierës. Gazet prej mjeteve janë në interval kohor të shkurtra dhe pa ndonjë ndikim në mjedisin përreth. Në aktivitetin e prodhimit të betonit ndotja e ajrit mund të vijë nga:

- Ajrit mund të ndotet gjatë lirim të pluhurit i cili krijohet gjatë zbrazjes së çimentos nga auto cisternat dhe mbushja e siloseve me çimento, gjatë sjelljes së çimentos nga siloset në mikser, nga mundësia e lirim të pluhurit të çimentos drejtpërdrejt nga vendet lidhëse të gypave përcjellës (transportues) të çimentos.
- Ndotja e ajrit mund të vijë gjatë lirim të gazrave nga gjeneratori, nga automjetet e transportit dhe automjeteve tjera të rënda që nevojiten për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit.
- Ajri mund të ndotet poashtu edhe nga procesi teknologjik për prodhimin e betonit nga ku lirohen grimcat e pluhurit të çimentos, dhe grimcat e pluhurit nga fraksionet e agregatit që përdoret për prodhimin e betonit, grimcat e pluhurave që depozitohen në afërsi të betonierës. Pluhurat kanë përbërje të elementeve kimike që posedon çimentoja dhe vetë lëndat minerale, si të tilla mund t'i bartë ajri për

shkak të reliefit dhe kushteve tjera mjedisore deri në distanca më të largëta, kjo situatë e përshkruar, kishte me qenë pa përdorimin e masave për zvogëlimin e pluhurit.

5.3 Ndikimet në ujë

Këto procese teknologjike nuk shoqerohen me shkarkime të lengeta të rrezikshme. Në këtë proces uji do të dozohet dhe përziejhet me inertet dhe çimenton në sasinë e kërkuar për prodhimin e betonit dhe si rrjedhim nuk do të ketë ujë që të dalë nga procesi teknologjik. Ajo sasi e paket e ujit që mund të derdhet duhet të kalon në vaska dekantuese dhe me pas i bashkohet linjes së shkarkimit. Ujërat që dalin gjatë largësive së automikserave dhe reshjeve do të orientohen përmes kanaleve përkatëse në vaskën e dekantimit dhe me pas për në mjedisin ujor prites. Projekti nuk ndikon negativisht në modelin drenazhues të zonës. Ai do të zbatohet vetëm në një sipërfaqe shumë të kufizuar dhe pa përdorim masiv të ujit. Megjithatë ndikime negative në ujë mund të shkaktohen:

- Uji mund të ndotet nga derivatet dhe vajrat e ndryshme që rrjedhin në tokë nga makinat e cekura më lartë. Derdhja e vajrave ndikon në ujërat sipërfaqësorë e me rastin e të reshurave mund të depërtojnë deri në ujërat nëntokësore. Gjithashtu në ndotjen e ujërave ndikon pluhuri i cili bartet me anë të ujërave sipërfaqësorë.
- Ujërat e përdorura në procesin teknologjik për prodhimin e betonit paraqesin dëmtim potencial të ujit, nga larja e pompave dhe automikserëve që përdoren për transportimin e betonit e automjeteve transportuese.
- Nga derdhja e ujërave të zeza,
- Nga mbeturinat metalike të korroduara të cilat janë të depozituara dhe mbeturinat tjera të ndryshme,
- Kompania nuk posedon sistemin e trajtimit të ujërave, qka është e dëmshme për trupin ujor, etj

5.4. Ndikimet në tokë

Ndotja e tokës në këtë rast karakterizohet me dy faza të ndotjes: faza parë përfshin periudhën gjatë ndërtimit të betonierës kurse faza e dytë periudhën gjatë procesit të përfitimit të betonit. Gjatë fazës ndërtuese ndikim negativ në tokë është paraqitur si rezultat i deponimit të dheut të gërmuar për bazamente, hapja e sipërfaqeve pyjore për bazamentin, poashtu efekt negativ kemi edhe nga mbeturinat e ngurta të cilat janë krijuar nga materialet ndërtimore gjatë fazës së ndërtimit, mbeturinat e ngurta komunale të cilat i krijojnë punëtorët. Ndotja mund të vije edhe nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet transportuese që transportojnë materialin ndërtimor. Gjatë fazës së aktivitetit për prodhimin e betonit, ndikime negative në mjedis paraqiten në tokë në këtë mënyrë: Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet punuese gjatë furnizimit dhe ndërrimit të tyre, gjatë pëlcitjes të gypave hidraulik të mjeteve punuese. Ndikimet nga mbeturinat e ngurta dhe lëngëta që krijohen nga larja e pompave, auto-mikserëve, mikesrit dhe automjetet tjera transportuese:

- Ndikim tjetër në tokë paraqitet edhe nga deponimi i materialeve të ndryshme të ngurta metalike të cilat mbesin nga riparimi dhe ndërrimi pjesëve të prishura të pajimeve prodhuese të betonierës, të cilat deponohen në sipërfaqet operacionale afër betonierës.
- Depozitimi i pluhurave që krijohet nga proceset teknologjike paraqesin efekt mjaftë të dëmshëm në hapësirat përreth, e poashtu edhe ngjeshja e tokës që vë në pasojë e makinave punuese dhe të tjerave gjatë punës së nevojshme në atë vend.
- Ndikimet negative nga mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të mekanizmave, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët.

5.5 Ndikimet në klimë

Gjatë zhvillimit të projektit nuk priten ndryshime të dukshme klimaterike, si në drejtim të përmiresimit ashtu edhe në ato të përkeqesimit të saj. Nuk do ketë ndryshime në

temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra, kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

5.6 Nivelet dhe ndikimet e zhurmave

Burimet e zhurmave janë në sipërfaqe. Çdo burim përhap vale zhurme. Fusha akustike qe rezulton varet nga karakteristikat e absorbimit dhe reflektimeve te te gjitha pengesave ekzistuese, ndërmjet burimit dhe receptorit. Kompania është kujdesur te importoje nga jashte pajisje bashkekohore dhe ne gjendje te mire teknike, ne menyre te tille qe zhurmat e krijuara prej tyre te mos sjellin ndotje akustike dhe te jene te demshme për mjedisin dhe shendetin e punonjesve. Ndikimet e zhurmave gjate fazes funksionale do te vijne nga mjetet qe do te sjellin lendet e pare ne linje, pajisjet e instaluara për përzierjen e aggregateve për prodhimin e betonit sipas markave te caktuara. Niveli i zhurmave te ketyre mjeteve transportuese është i atij niveli qe nuk influencon si për te punesuarit dhe për banoret dhe gjallesat për rreth tij. Koha ne te cilen do te jene te pranishme keto zhurma është vetem gjate dites, meqenese ne objekt do punohet vetem me nje turn. Niveli i zhurmave te ketyre mjeteve ne largesi nuk do te jete i madh dhe do te jete konform normave ne fuqi, megjithate duhet bere analizat perkatese edhe per matjen e nivelit te zhurmes, sidomos per shkak te banoreve te cilet jetojne ne afersi dhe qe mund te paraqitet pengese, nese zhurma kalon kufijte e lejuar.

5.7. Ndikimi në Peisazh

Lokacioni ku ndodhet betoniera dhe objektet e saj përcjellëse nuk është vend industrial i zhvilluar, është tokë pyjore, andaj për zhvillimin e kësaj veprimtarie është bërë degradim i konsiderueshëm natyror. Gjatë fazës së ndërtimit peizazhi ka pësuar një dëm të konsiderueshëm, i cili me masat që do të merren në mbarim të jetë-gjatësisë së projektit, peizazhit do ti kthehet pamja në harmoni me gjendjen e përafërt të mjedisit rrethues. Këto masa do të arrihen me aplikimin e rikultivimit.

5.8. Ndikimi në florë dhe faunë

Për shkak të proceseve operuese që zhvillohen në Betonier në gjatësinë kohore të operimit dhe në sipërfaqet operuese për rreth betonierës flora tërësisht është shkatërruar, e cila

proponohet të gjelbërohet me aq mundësi dhe hapësirë që të këtë, poashtu domosdoshmërisht duhet të rikultivohet pas përfundimit të punëve prodhuese. Fauna nuk do të dëmtohet fizikisht për arsye se do të largohen nga regjioni i veprimtarisë prodhuese dhe do të zhvillohet në terrenin e përafërt që i përshtatet faunës, pa anashkaluar faktin se një pjese të botës shtazore i janë shkatërruar foletë e tyre, kryesisht zvarranikë. Gjatë kohës kur pushon aktiviteti prodhues fauna prapë kthehet për t'u zhvilluar në hapësirat e mëparshme.

5.9. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Ndikimi negativ në vendbanimet përreth është minimal, pasi që edhe nuk ka qenë nevoja të bëhet zhvendosja e ndonjë objekti apo ndërtese që të krijohet hapësira e nevojshme për ndërtimin e objektit. Kjo falë largësisë dhe pozitës së përshtatshme ku ndodhet lokacioni i betonierës. Zhvillimi i aktiviteti në fjalë në këtë zonë edhe pse jo të zhvilluar, ka rëndësi për popullatën e këtij lokaliteti. Parashihet punësim i disa punëtorëve kryesisht nga popullata vendase nga ana e pronarit të Kompanisë "JONI" SHPK, megjithëse mjaftë modest do të ndikojë pozitivisht edhe në ekonominë lokale.

5.10 Ndikimet në ekonomi

Përsa i përket ndikimeve ekonomike ky projekt do të sjell efekte direkte në punësimin e popullsisë së zones gjatë funksionimit të tij, pra do të rris tregun e punës si rrjedhim do të rritet edhe mirëqenia e nivelit të jetesës të popullsisë së zones. Duke qenë një aktivitet i prodhimit, tregtimit dhe shpërndarjes së betonit që është një element që i vjen në ndihmë industrisë së ndërtimit.

5.11. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Pasi që aktiviteti i betonierës dhe pajimet tjera përcjellëse janë mirë të projektuara, të vendosura dhe të monitoruara nga ekspertë, pastaj veprimtaria në fjalë nuk funksionon me materie të rrezikshme për mjedisin, konkludojmë që aksidente mjedisore të mëdha nuk mund të ndodhin. Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo kohë gjatë realizimit të procesit teknologjik si:

- Nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese:
- Nga mekanizmi punues

- Nga mundësia e pëlcitjes së gypave hidraulik.
- Nga aksidentet e mundshme në komunikacion gjatë transportit të agregatit, çimentos dhe betonit.
- Nga aksidentet e mundshme në komunikacion gjatë kyçjes së automjeteve transportuese nga baza e betonit në rrugën kryesore.
- Nga aksidentet e mundshmenë rast të vërshimeve eventuale.

6.0. MARRJA E MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave për uljen e ndotjeve gjate procesit te prodhimit te betonit, si te pluhurit ne ajer, zhurmave, erozionet si dhe uljen e efekteve negative hapsinore ne territor, faun dhe flore.

6.1 Masat për emetimet në ajër

Aktiviteti për prodhimin e betonit nuk sjell emetime te gazeve ne atmosfere sepse nuk përdore lende djegese gjate zhvillimit te aktivitetit te tij prodhues. Lenda djegese përdoret vetem nga mjetet e transportit te lendeve te para si dhe produktit përfundimtar. Sillosat jane te mbyllur ne menyre hermetike. Ne linje është instaluar filtri i pluhurave te çimentos ne menyre qe pluhuri te mos dale ne atmosfere. Vazhdimisht duhet të ndërrohen filterat e ajërit. Pra, i gjithë procesi është nje cikel i mbyllur dhe nuk emeton pluhura. Përsa i përket pluhurave qe krijohen gjate procesit te ngarkimit apo shkarkimit te lendeve te para nga ana e shoqerise ne menyre përiodike sidomos ne kohe te thate do te behet lagia e territorit me uje për shmangien e pluhurit. Transportuesit jane prej gome te hermetizuar si dhe ne linje do te instalohen filtra për pluhurat ne menyre qe te mos ket emetim te tyre ne atmosfere. Punonjesit do te jene te pajisur me maskat përkatese për mbrojtjen ndaj tij. Përreth linjes do të bëhet sistemimi i ambjentit për qellim mbrojtjen e peizazhit duke bere mbjelljen e pemeve me gjelberim te përhershem si dhe me lule dekorative. Nga ana e personelit te shoqerise do te tregohet nje kujdes i vecante për mirembajtjen e tyre.

6.2 Masat për shkarkimet në ujë

Sic është theksuar edhe me sipër ky proces nuk shkarkon në mjedis ujor prites ujera të ndotura nga procesi i prodhimit të betonit. Uji përdoret si element përzieres në beton sipas recepturave të caktuara dhe nuk ka teprica të tij. Ujerrat që dalin gjatë largjes së autobetonierëve dhe reshjeve orientohen përmes kanaleve përkatëse në vasken e dekantimit dhe më pas për në mjedisin ujor prites. Në mënyrë periodike nga ana e kompanisë do të bëhet pastrimi i kanaleve orientues si dhe vaskes së dekantimit. Fraksionet e inerteve që dekantohen aty rifuten në procesin e prodhimit të betonit dhe asfalto-betonit. Për levizjen e ujërave të shiut është ndërtuar sistemi i drenazhimit ndërsa përse i përket ujërave të bardha dhe të zeza ato i bashkohen sistemit të kanalizimit të vendosur nga pushteti lokal.

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ujë të cilat i kemi cek më lart duhet ndërmarr këto masa:

- Në lokalitetin e betonierës duhet të bëhet sistemi për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura të krijuara nga procesi i prodhimit, nga larja e automjeteve transportuese, auto-mikserëve për transportimin e betonit dhe automjeteve tjera të rënda, ujërave nga të reshurat atmosferike.
- Duhet rregulluar sistemin gypor për bartjen e ujërave të ndotura të cilat duhet të dërgohen për trajtim në puse sedimentuese për pastrimin e ujërave të ndotur me grimca të ngurta.
- Kolektorët duhet të rregullohen në pozicionet e caktuara me qëllim që e tërë sasia e ujërave industriale dhe e të reshurave atmosferike nga platot dhe nga tëra sipërfaqet funksionale të grumbullohen dhe të orientohen në puset sedimentuese e pastaj në seperator.
- Duhet të ndërtohen tre puse sedimentuese në atë mënyrë që të mund të sedimentohen grimcat e ngurta, e pas trajtimit të ujërave në puset sedimentuese, uji të orientohet për trajtim të mëtejshëm në seperatorin për pastrimin e ujërave të ndotur nga derivatet dhe vajrat të cilat kanë rrjedh në sipërfaqet operacionale, nga pajimet e punës, pastaj ujërat e trajtuara nga seperatori të lirohen në recipient.

- Seperatorit duhet të rregullohet në atë mënyrë që të mundë të kontrollohet rregullisht uji i cili pastrohet dhe të merren mostrat e ujit i cili pastrohet.
- Duhet rregullisht të pastrohen pusët sedimentuese dhe separatori. Mbeturinat të cilat nxjerrën nga separatori pas pastrimit të tij duhet të dërgohen në deponi regjionale, mbeturinat të cilat nxjerrën nga pusët sedimentuese do të përdoren si material riciklues të rikthehen në proces të prodhimit të betonit.
- Ujërat e zeza duhet së pari të trajtohen në gropën septike e cila duhet të ndërtohet në varshmëri me numrin e punëtorëve, dhe pas trajtimit të lëshohen në recipient të pastërta.
- Gropa septike duhet të pastrohet nga kompanitë e licencuara. Rekomandohet që të ndërtohet një rezervuar me qëllim të mbajtjes së ujërave të trajtuara, uji i trajtuar (pastruar) do të rikthehet në procesin teknologjik, kështu që do të mbyllet cikli i trajtimit dhe furnizimit me ujë industrial, dhe do të parandalohet shkarkimi i ujërave. Do të ekzistojnë dy mundësi të shkarkimit të ujërave të trajtuara njëra drejt për drejt nga separatori në recipient, tjetra mundësi prej separatorit në rezervuar, prej nga do të shkarkohet në recipient nëse nuk nevojitet për procesin teknologjik

6.3 Masat për mbrojtjen e tokës

Mbetjet e ngurta që vijnë si rezultat i projektit janë dherat që rezultojnë nga germimet e bera për nivelim të territorit për instalimin e linjes së prodhimit. Këto dhera depozitohen në një vend të veçantë në mënyrë që të ripërdoren për rehabilitimin e zonës. Gjate procesit të funksionimit ky aktivitet nuk gjeneron mbetje të ngurta në formë sterile të demshëm për mjedisin, fraksionet e inerteve hidhen me masën e duhur në autobetoniere për procesin e përzierjeve të betonit, ndërsa masa e ngurte që dekantohet në gropën dekantuese rifuten në proces. Mbetje të tjera të cilat dalin nga aktiviteti i përditshëm i punëtorëve do grumbullohen në kontener dhe më pas largohen për në vendin e caktuar nga pushteti lokal i zonës konform kërkesave të përcaktuara.

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë gjatë fazës së ndërtimit të bazës së betonit duhet të merren këto masa:

- Dheu i gropuar duhet të shfrytëzohet për rrafshimin, planifikimin e terrenit i cili duhet të mbillet, pjesa tjetër e dheut duhet të dërgohet ne deponin regjionale,
- Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen nga materialet ndërtimore duhet të klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, dhe të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren dhe shitën për nevoja komerciale duhet të dërgohen ne deponin regjionale.
- Mbeturinat e ngurta komunale të grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, kontejnerët duhet të sigurohen për deponimin e të gjitha llojeve të mbeturinave të klasifikuara ne bazë te rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligj të mbeturinave, pas mbushjes së kontejnerëve përmes ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponin e qytetit.
- Vaji i makinave ngarkuese dhe transportuese që nevojiten për ndërtimin e betonierës të ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë, vajrat e përdorura duhet të deponohen në enë të posaçm , dhe pastaj t'u dorëzohen ndërmarrjeve të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë gjatë fazës së operimit të bazës së betonit duhet të merren këto masa:

- Duhet në mënyrë të rregullt të mirëmbahen stabilimentet që nevojiten për realizimin e procesit për prodhimin e betonit, të mirëmbahen filtrat në siloset e çimentos, të mirëmbahen gypat të cilët përdoren për përcjelljen e çimentos prej auto-cisternave gjer në silos dhe prej silosit gjer në pajimet për prodhimin e betonit, të gjitha pjesët lidhëse të gypave të puthiten mirë me qëllim të pengimit të lirit të pluhurit.
- Duhet të merren masat e nevojshme për mos lëshuarjen e pa kontrolluar të derivateve dhe vajrave nga makinat dhe pajimet prodhuese.

- Të bëhet betonimi i platos ku janë të vendosura pajimet për prodhimin e betonit dhe sipërfaqet tjera operationale.
- Vaji i makinave të ndërrohet në vende të caktuara të betonuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë.
- Të bëhet betonimi i platos ku deponohen mjetet themelore dhe sekondare që nevojiten për punët në ndërtimtari të ultë dhe lartë.
- Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen në lokacionin e betonierës duhet të grumbullohen dhe klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, ato metalike të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren për nevoja të kompanisë të shiten kompanive të licencuara.
- Mbeturinat e ngurta komunale të grumbullohen dhe vendosen në kontejner të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, me transport vetanak apo nëpërmjet ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponin regjionale.
- Vajrat motorike dhe ato të mirëmbajtjes së pajimeve të betonierës duhet të deponohen në enë të posaçme, dhe të u dorëzohen ndërmarrjeve të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.
- Të bëhet betonimi apo asfaltimi i rrugës që lidhë betonierën me rrugën magjistrale.
- Sipërfaqet jo funksionale të mbjellën me bimë gjelbëruese, si dhe të mbillen drunj dekorativ gjeth mbajtës.

6.4. Masat për mbrojtjen e florës dhe faunës

Sipas analizave të bëra deri tani në lidhje me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës mundë të vie deri te ndikimet në florë dhe faunë.

Mirëpo sipas gjendjes faktike në teren respektivisht në lokacionin e caktuar nuk kemi zhdukje të vegjetacionit pos nga sipërfaqet manipulative, nga sipërfaqja nën pajisjet e bazës të betonit kjo do të thotë se kemi të bëjmë me koncentracion të vogël të polutantëve. E njëjta do të vlente edhe për faunën që do të thotë se nuk pritet të ketë ndikime negative. Kompania nuk duhet të deponoj pa kontroll mbeturina në vende të ndryshme por ato duhen të deponohen në vende me destinacion të caktuar. Në raste të lajmërimit të zjarrit

menjëherë të merrën masa për neutralizimin e tij në mënyrë që të mos dëmtohet bota bimore. Pajisjet kundër zjarrit duhen të ruhen në mënyrë të veçantë. Për mbrojtjen e botës shtazore kompania duhet të tregoj kujdes duke kufizuar lëvizjet e të punësuarve jashtë zonës operuese dhe të kenë kujdes në nivelin e zhurmës, kualitetin e ajrit, ujit, etj

6.5. Masat e marura për mbrojtjen nga zhurma

Për të parandaluar dhe monitoruar dëmin e shkaktuar nga zhurma, duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtjen nga zhurma. Matjet zakonisht bëhen në afërsi të objekteve të banimit por meqë në afërsi shumë të afërt nuk ka ndonjë shtëpi banimi, kjo gjë nuk është dhe aq e nevojshme. Për vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me vlerat e lejuara me standarde për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit. Në raste se zhurma nga matjet tejkalon at të lejuarën atëherë duhet të merren të gjitha masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e lejuar sipas rregullave në fuqi. Në varshmëri nga fazat e procesit të punës duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjete mbrojtëse kundër zhurmës.

Masat që do të merren për minimizimin e zhurmave nga ana e shoqërisë janë:

- Makinat e transportit dhe pajisjet gjate fazes se ndertimit do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore, te pajisura ne marmita selenciatore te pakesimit te zhurmave.
- Për te ulur me tej ndikimin nga zhurmat punetoret detyrimisht do te përdorin paisjet e mbrojtjes ne pune “kufje”

6.6 Masat e marura për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale

Duhet të bëhet plani i intervenimit për raste të aksidenteve ekologjike. Duhet të bëhet plani i mbrojtjeve nga zjarri. Duhet i tërë oborri i betonierës të thuret me mure nga betoni me qëllim të marrjes së masave të sigurisë ndaj vërshimeve eventuale. Të merren të gjitha masat për evitimin e derdhjes së derivateve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese dhe ngarkuese si dhe pajimet tjera. Të merren të gjitha masat e sigurisë për kycjen e automjeteve transportuese në rrugën magjistrale pa penguar komunikacionin. Të merren të gjitha masat e sigurisë konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës.

Sigurimi teknik dhe mbrojtja ne pune –Aktiviteti për prodhimin e betonit nuk përdor lende te demshme dhe te rrezikshme si për mjedisin ashtu edhe për punonjesit. Lendet e para qe futen ne proces nuk pesojne ndryshime kimike. Për shmangien e aksidenteve nga pajisjet dhe makinerit tregohet nje kujdes i vecante nga punonjesit për mirembajtjen e gjendjes se tyre teknike si dhe zbatohen me rigorozitet kushtet e sigurimit teknik. Gjithashtu ne menyre periodike punonjesit instruktohen për rreziqet ne pune dhe masat e menytrat për parandalimin e tyre. Për te krijuar nje ambjent pune optimal dhe funksional kompania “JONI” SHPK do te pajise te gjithë punonjesit qe do te punojn ne linjen e prodhimit te betonit dhe asfalto-betonit me uniformat dhe mjetet mbrojtese perkatese. Regulloret e Teknikes se Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik dhe shoqerise , do te zbatohen ne cdo proces pune te përcaktuar ne plan- organizimin e kryerjes se proceseve te punes te hartuar nga drejtuesi teknik i punimeve dhe te miratuar nga drejtuesit e shoqerise , i cili do te përmbaje :

- Plan organizimi i punes hartohet nga drejtuesi teknik.
- Drejtuesi teknik i punimeve, ose personi i ngarkuar, do te beje kontrollin teknik për ecurine dhe mbarevajtjen sa me te mire te proceseve te punes.
- Drejtuesi teknik i punimeve do te kryeje instruksione te rregullta mujore e tre mujore për punonjesit.
- Kujdes i vecante do te tregohet ne krijimin e kushteve te punes sa me konforte për punonjesit.

7.0 PLANI I MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TE MJEDISIT

Monitorimi i mjedisit është nje proces i cili duhet te përmbaje nje program sa me te plote për te trajtuar dhe për te përballuar te gjitha problemet qe mund te lindin nga zbatimi i ketij projekti dhe për ti zvogeluar keto ndikime. Menaxhimi mjedisor është nje siguri dhe nje mbeshtetje për zbatuesit e projektit për cdo avari te papritur qe mund te ndodh dhe gjithashtu mund te përdorin nje skeme te gatshem për te përballuar keto probleme qe mund te lindin gjatë fazave te zhvillimit. Skema e menaxhimit mjedisor përmban këto objektiva afat-gjata:

- Mbeshtetje e plote me legjislacionin dhe politikën e kompanisë
- Përzgjedhje të politikave me të mira mjedisore dhe të performancave të ndërtuara rreth parimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të gjendjes së mjedisit
- Bashkepunim të plote të mjedisit me projektin
- Praktika me të mira për çdo nderhyrje mjedisore për të rritur në këto mënyra vlerat e efektivitetit
- Inkurajimi për të arritur performancën e lartë nga punonjësit dhe kontraktorët individualë
 - Për të siguruar standardet për planifikimin e përgjithshëm, funksionimin, kontrollin dhe rishikimin
 - Menaxhimi duhet të paraqesë prioritetet mjedisore
 - Të jetë i zbatueshëm në të gjitha fazat e projektit
 - Para zbatimit të projektit duhet të zhvillohen konsultimet e para me banorët e zonës dhe autoritetet vendore dhe të merren në konsideratë çdo lloj ndihme vullnetare.

8.0. RAPORTIMI

Raportimi do të kryhet nga udhëheqja, gjegjësisht nga ekspertët e kompanisë “JONI” SHPK së paku në fund të çdo viti kalendarik, ku do të paraqiten të dhënat relevante nga të gjitha monitorimet e bëra brenda vitit, të cilat do të raportohen në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor sipas kërkesës së tyre si dhe sipas kërkesave dhe rekomandimeve të legjislacionit në fuqi dhe komunitetit lokal brenda komunës.

9.0. MARJA E MASAVE REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETEVE PRODHUESE

Pas përfundimit të jetë gjatësisë së betonierës, e kjo varet nga vjetërsia e pajimeve dhe nga pronari se, a do të vazhdojë me këtë projekt me blerjen e pajimeve të reja apo do të përfundojë aktivitetin e prodhimit të betonit. Pas afatit të përfundimit të aktivitetit prodhues, pajimet e betonierës duhet të çmontohen dhe në bazë të leverdis së kompanisë të shitën si material i vjetruar. Bazamentet si dhe platot nga betoni duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponi të qytetit. Si rezultat i punës nga aktiviteti

teknologjik i prodhimit të betonit do të krijohen substrate që i takojnë kategorisë së tokave të dëmtuara d.m.th. substrate të pa përshtatshme(sterile) për rikultivim. Substrate me përmbajtjes të gurit gëlqeror, rërës, zhavorri dhe betoni, etj. Që pa tjetër duhet të largohen dhe të bëhet zëvendësimi, me një shtresë të humusit prej 0,5m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e e kësaj shtrese të humusit (dheut) me qëllim që të jetë shtresa ma kompakte, ashtu qe të krijohet një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivim. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga: Qëllimi i rekultivimit i cili nënkupton që pas përfundimit të punëve në procesin teknologjik, sipërfaqeve të degraduara, prapë t'u kthehet funksioni i saj primar (prodhimi i biomasës), dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem. Planifikimi i shfrytëzimit të tokës, planifikohet që toka në lokacionin e betonierës të kthehet në gjendje të përafërt me ambientin rrethues dhe të mbillen bimë të cilat kanë qenë më parë të mbjellur para degradimit, apo lloje të nejta me habitatin rrethues.

10.0 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

10.1 Konkluzione

Zbatimi i projektit nuk do të ketë pasoja negative te mundshme në mjedisin e zones. Ndikime minimale do të ketë vetem në ndryshimin e peizazhit të sipërfaqes ku do të instalohet linja e prodhimit te betonit.

o Procesi teknologjik i prodhimit te betonit nuk shoqerohet me shkarkime të lëngta të rrezikshme. Ujerat që përdoren në linjën e prodhimit te betonit thuhet nuk kanë teprica sepse dozohen ne sasi te përcaktuara, sasite minimale shkarkohen vetem pas dekantimit te mases se ngurte ne vasken dekantuese. Meqenëse lendet e para te përdorura për prodhimin e betonit jane inerte, këto ujera nuk kanë elemente qe mund të kontaminojnë mjedisin ujor prites, sipërfaqësore, nentokësore apo tokën.

o Përreth perimetrit te objektit do të ndërtohen kanalet drenazhues për ujerat atmosferike ne menyre që të shmanget fenomeni i erozionit.

- o Ky aktivitet nuk përdorë lëndë të rrezikshme për shëndetin e punonjesve si dhe të popullsisë përreth zones dhe si rrjedhim nuk ndikon negativisht tek ata.
- o Ky projekt nuk sjell emetime të gazeve në atmosferë. Gjatë procesit të ngarkimit - shkarkimit të materialit në bunkere, bëhet pluhur i lehtë dhe drejtuesit e kompanisë do të marrin masa për spërkatjen me ujë të bunkereve, për paisjen e punëtorëve dhe manovratorëve të mjeteve të rënda me mjetet e domosdoshme për mbrojtjen nga pluhuri, si kominoshe pune, kapele mbrojtëse, doreza pune, maska për mbrojtjen nga pluhuri.
- o Niveli i zhurmave që vijnë nga automjetet dhe pajisjet e tjera janë brenda normave të lejuara. Nuk përbejnë problem shqetësues për punonjësit dhe as për banorët e zonës përreth që janë në një distancë të konsiderueshme.
- o Furnizimi me ujë do të sigurohet nga pusi i shpuar brenda punishtës.
- o Furnizimi me energji elektrike do të sigurohet nga rrjeti ekzistues që mbulon zonën duke plotësuar të gjitha kushtet teknike.
- o Zona ku do zbatohet projekti nuk njihet si zonë e mbrojtuar me vlera arkitektonike dhe kulturore, pra nuk kemi ndryshime apo demtime të saj duke qenë se nuk ekziston në këtë territor.
- o Për një punë sa më optimale në impiant zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe punëtorët e manovratorët njihen me këto rregulla në mënyrë periodike nga drejtuesit teknik të kompanisë.

10.2 Rekomandime

Duke ditur se gjatë proceseve të punës në linjë emetohen në mjedis pluhur i lehtë, ka zhurma të makinerive për të rritur sigurinë në punë të punonjësve dhe për të ulur në maksimum impaktin në mjedis, duhet të:

- Të bëhet rregullisht monitorimi i gjendjes teknike të automjeteve.
- Të bëhet monitorimi periodik i emetimit të zhurmave në mjedis.
- Të bëhet vendosja dhe ndërrimi i filtrave në mënyrë periodike.
- Të bëhet monitorimi periodik i emetimit të pluhurit në ajër.
- Të ndërtohet kanali drenazhues rreth gjithë sipërfaqes operacionale (bazës së betonit) më qëllim të grumbullimit të ujrave të shpërlarjes së betonierës,

automikserave dhe pompes si dhe lidhja e këtij kanali me kolektor dhe pusët sedimentuese.

- Të ndërtohen pusët sedimentuese (dysHEMEJA dhe muri për rreth pusit sedimentues të jetë e betonuar).
- Të krijohet sistemi për kthimin e ujit në proces teknologjik.
- Kontenieret me aditiv të vendosen në vaska speciale me kapacitet të njëjtë të kontainerit.
- Te pastrohen dhe mirëmbahen kanalet e drenazhimit të ujërave përreth perimetrit të linjes si dhe pusët sedimentuese.
- Te kontrollohet kompletimi me mjete mbrojtëse nga zjarri.
- Te respektohen normat e teknikes së sigurimit në punë nga punëtorët.

Mendojmë se të dhënat e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis janë të mjaftueshme dhe i propozojmë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës (MMPHI), për dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Mjedisor sipas kërkesës së investitorit - aplikuesit "JONI" SH.P.K me pronar Femi Kryeziu.